

Nr. Prot. 823

H. A. ESTEROS



Nr. 156 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E BRENDSHME  
PREFEKTI I QARKUT KORÇË

Secretari Përgjithshëm  
Vijeni zyrtarisht sipas ligjit  
Shtetërore e Këshillit  
Përfundim 17.02.2025

Korçë, më 14 .02.2025

Lënda : Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit

## KËSHILLIT TË BASHKISË KOLONJË

### KRYETARIT TË BASHKISË KOLONJË

Mbështetur në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pas verifikimit të vendimeve nr. 4, nr. 5, nr. 9, datë 30.01.2025 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë, **konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tyre**, bazuar në nenet 3, 8, 9, 24, 27, 54, 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 119, datë 26.11.2024 "Për miratimin e kalendarit për programin buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2025", në ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 4.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", i ndryshuar, në ligjin nr. 57/2020 "Për pyjet", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish-Komunave/Bashkive", i ndryshuar.

Lidhur me vendimin nr. 11, datë 30.01.2025 "Për miratimin e ndërtimit të një objekti banimi me banesa sociale në truallin në pronësi të Bashkisë" **nuk konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij**, për arsye se mungon relacioni përmbledhës i aktit. Referuar nenit 16, pika 2, a të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut, i ndryshuar, përcaktohet se aktet me karakter normativ shoqërohen me një relacion përmbledhës të arsyeve për nxjerrjen e tyre, duke argumentuar për problematikat, qëllimet, objektivat që synohen të arrihen, përparësitë, si dhe efektet e pritshme nga miratimi.

Gjithashtu, kërkohet nga ana juaj të përcaktohet nëse qëllimi i këtij vendimi realizohet duke përdorur intesitetin e ndërtimit me kushte. Në rast se gjendeni në kushtet e përdorimit të këtij instrumenti zhvillimi territori, kërkohet nga ana juaj saktësimin e referimit ligjor të aktit dhe të citohet në relacion respektimi i kriterëve të përcaktuara në rregulloren e zhvillimit të territorit.

Lidhur me vendimet nr. 10, nr. 12, nr. 13, nr. 14, nr. 16 datë 30.01.2025 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë, institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë konsideron që aktet nuk përmbushin kriteret e aktit administrativ normativ dhe shqyrtimi i ligjshmërisë së tyre tejkalon kompetencat e dhëna me ligj.

Lidhur me vendimin nr. 15, datë 30.01.2025 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë sqarojmë se objekti i aktit është miratim procedurash për zbatimin e programit social të strehimit, por në dispozitiv shpreheni për miratim vijim procedurash që do të ndiqen konform kërkesave të programit të rindërtimit, miratim listash etj, pra akti nuk miraton procedura në rastin në fjalë sikurse përcaktohet në objekt. Relacioni bashkëlidhur vendimit citon bazë ligjore dhe vetëm propozimin e miratimit të listës së personave

përfitues nga programi. Institucioni i Prefektit të Qarkut kërkon nga ana juaj në vazhdimësi formulimin e saktë të akteve, në përputhje objekti me dispozitivin dhe relacionin.

Për sa më sipër, në konkluzion konsiderojmë që akti i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht të së drejtës duke krijuar një marrdhënie konkrete juridike dhe rrjedhimisht shqyrtimi i vendimit nuk është në kompetencën e institucionit.

Shënim : Referuar udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore", pika 59 përcakton se në raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave përfshihen: metodologjia e përdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave, analiza e efekteve të politikave të reja fiskale ose të ndryshimit të atyre ekzistuese dhe analiza e risqeve dhe masave për përballimin e tyre. Lutemi që në vazhdimësi në relacion të përdoren konceptet e përdorura në legjislacion dhe të respektohen përcaktimet ligjore në mënyrë të detajuar.

